



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2021
Nr.ref.:RK1786/21

VENDIM PËR REFUZIM

në

rastin nr.KI18/21

Parashtrues

Ruzhdi Latifi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0090-A0001, të 10
dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ruzhdi Latifi, i cili pretendon të jetë i përfaqësuar nga Haki Pajaziti nga Komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-I-19-0090-A0001] e 10 dhjetorit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktvendimin [C-IV-14-0515] të 23 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 janar 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 2 shkurt 2021, Gjykata e (i) njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës; dhe (ii) kërkoi nga ai që të sqarojë nëse ai e përfaqëson veten e tij para Gjykatës, apo nëse përfaqësohet nga avokati Haki Pajaziti, dhe nëse ky është rasti, të sjellë autorizimin e vlefshëm për përfaqësim pranë Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.
8. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 maj 2008, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM), ndër të tjera, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se shitja e NSH

“Kualiteti” Gjilan është vërtetuar nga Bordi i AKM-së dhe se pasojë e shitjes së aseteve përkatëse, është përfundimi i punësimit të tij.

10. Më 15 mars 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pranë Zyrës Rajonale në Gjilan të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), përmes së cilës kërkoi (i) anulimin e “vendimeve të paditurës NSHIMB “Kualiteti” Gjilan”; (ii) kompensimin për pagat e papaguara në shumë prej 17,236 euro dhe kontributet pensionale në shumë prej 1,732.50 euro për periudhën 1991-2000; si dhe (iii) kompensimin për paga të papaguara në shumë prej 14,980.00 euro dhe kontribute pensionale në shumë prej 1,960.00 euro për periudhën 1999-2008, në vlerën totale prej 35,994.50 euro, për shkak të “ndërprerjes së marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar”.
11. Më 24 dhjetor 2013, Autoriteti i Likuidimit i AKP-së përmes Vendimit [GJI005-0347], refuzoi si të pavlefshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se bazuar në pikën 1 të paragrafit 2 të nenit 36 (Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta) të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për AKP-në) dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar të vitit 1976, kërkesa është parashkruar, pasi “kanë kaluar 3 vite nga ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe paditësi nuk ka ndonjë provë që ka dorëzuar kërkesë padi në gjykatë apo në ndonjë organ tjetër kompetent brenda afatit tre vjeçar”.
12. Më 28 janar 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), duke kërkuar anulimin e Vendimit të lartcekur të AKP-së, ndër të tjera, me pretendimin se (i) nuk është marrë parasysh se paditësi “është viktimë dhe i diskriminuar nga organi i dhunshëm serb dhe me dhunë është larguar nga puna”; (ii) “Kuvendi i Serbisë në mënyrë të kundërligjshme ka marrë vendim për ndërmarrjen e masave të përkohëshme për mbrojtjen e të drejtave vetqeverisës dhe pronën shoqërore kundër Ndërmarrjes Shoqërore “Industria e Miellit dhe Bukës” në Gjilan”; dhe (iii) “Organi i dhunshëm serb ... nuk ka zgjedh mjete dhe me dhunë punëtorët shqipëtar i ka larguar nga vendi i punës dh kryesisht ka marrë vendime pa kurrëfarë udhëheqje të procedurës disiplinore...”. Ndërsa, më 22 prill 2016, AKP, parashtroi përgjigje në padi, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.
13. Bazuar në shkresat e lëndës, më 28 janar 2019, DHPGJS, përmes Vërejtjes për Pagesën e Taksave Gjyqësore, njoftoi parashtruesin e kërkesës se (i) është i obliguar të paguajë taksën gjyqësore për ankesë të përcaktuar sipas neneve 13.7 dhe 13.9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ); (ii) nëse taksa përkatëse nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar, padia do të konsiderohet e tërhequr; dhe (iii) bazuar në nenin 8 (Lirimi nga pagesa e taksave) të Udhëzimit Administrativ, parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë lirimin nga taksat gjyqësore për shkak të mungesës së mjeteve financiare.
14. Më 23 maj 2019, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [C-IV-14-0515], refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Përmes këtij

Aktvendimi, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, theksoi se (i) vërejtja për të paguar taksën gjyqësore i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 28 janar 2019; dhe (ii) duke marrë parasysh që e njëjta nuk ishte paguar, ankesa konsiderohet e tërhequr.

15. Më 14 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktvendimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar se është e pasaktë që i njëjti ka pranuar vëretjen për pagesën e taksës gjyqësore më 28 janar 2019.
16. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0090-A0001] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [C-IV-14-0515] e 23 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së. Përmes këtij Aktvendimi, Kolegji i Apelit, ndër të tjera, theksoi se (i) DHPGJS kishte lëshuar vëretjen gjyqësore për pagesën e taksës gjyqësore më 28 janar 2019; (ii) bazuar në fletëkthesën përkatëse, vërejtja ishte pranuar nga paditësi më 11 mars 2019; (iii) i njëjti as nuk kishte paguar taksën gjyqësore dhe as nuk kishte parashtruar kërkesë për lirim nga taksa; dhe për pasojë (iv) bazuar në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 253 (Përmbajtja e padisë) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), ankesa përkatëse, për mungesë të pagesës së taksës gjyqësore, duhet të konsiderohet e tërhequr.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-I-19-0090-A0001] e 10 dhjetorit 2020 të Kolegjit të Apelit i DHPGJS-së me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar dispozitat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar, por në esencë, ngritë pretendime që ndërlidhen me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
18. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjerash, thekson se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është nxjerrë në shkelje të paragrafit 1 dhe 2 të nenit 182 [pa titull] dhe nenit 184 [pa titull] të LPK-së, sepse *“Kolegji i Apelit provat materiale nuk i ka shtjelluar fare, po ashtu edhe ankesën e ushtruar nuk e kanë analizuar fare sipas kësaj çështje juridike”* dhe *“Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS, është dashtë dhe kanë pas për detyrim që të na thirrin dhe të ndëgjohem, një veprim të tillë fare nuk e kanë bërë”*.
19. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; dhe (ii) të anulohet Aktvendimi [AC-I-19-0090-A0001] i 10 dhjetorit 2020 i Kolegjit të Apelit i DHPGJS-së në lidhje me Aktvendimin [C-IV-14-0515] e 23 majit 2019 të Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, duke e kthyer çështjen e tij në rivendosje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

22. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”
[...]

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

23. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën.”

[...]

24. Ky rregull i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse.
25. Duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte e paplotë dhe e paqartë, më 2 shkurt 2021, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f), (g) dhe (h) të paragrafit (2) të rregullit 32 të Rregullores së punës, Gjykata i kërkoj parashtruesit të kërkesës që të sqarojë, nëse ai e përfaqëson veten e tij para Gjykatës apo nëse përfaqësohet nga avokati H.P., dhe nëse ky është rasti, të sjellë autorizimin e vlefshëm për përfaqësim pranë Gjykatës. Siç është sqaruar më lart, parashtruesi i kërkesës, nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës. Duke marrë parasysh që sqarimet e nevojshme nuk janë dorëzuar në Gjykatë, kjo e fundit, duhet të konstatojë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
26. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, gjithashtu rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI 60/20, parashtrues: *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
27. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi

